

**LIGJ**  
**Nr. 58/2022**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PARQEVE**  
**TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2026, datë 2.4.2026)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim që nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të parqeve teknologjike dhe shkencore të realizojë nxitjen e një ose më shumë objektivave:

- a) zhvillimin e industrive të teknologjisë së lartë dhe inovacionit;
- b) kërkim-zhvillimin për produkte dhe shërbime të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese;
- c) krijimin e vendeve të kualifikuara të punës për profesionistë të fushave të shkencës e të teknologjisë.

**Neni 2**

**Objekti**

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore (në vijim “parqet”).

**Neni 3**

**Përkufizime**

*(Shtuar fjali në shkronjën “dh”, shtuar shkronjat “f”, “g”, “gj” dhe “h” me ligjin nr. 35/2026, datë 2.4.2026)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Infrastrukturë e përgjithshme” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik;
- b) “Inovacion në prodhim” janë metodat e përdorura në prodhimin e produkteve të reja ose të përmirësuara, të cilat nuk mund të prodhohen në mjediset ekzistuese ose prodhohen me teknika apo metoda inovative;
- c) “Kërkim dhe zhvillim” janë veprimtari që ndërmerren me qëllim përfitimin e njohurive të reja për zhvillimin e shkencës e teknologjisë dhe aplikimin e tyre nëpërmjet inovacionit në produkte ose shërbime;

ç) “Menaxhues” është personi fizik ose juridik, vendës ose i huaj, i cili zotëron njohuritë e nevojshme në lidhje me funksionimin e parkut dhe identifikimin e përdoruesit të parkut;

d) “Park” është sipërfaqe e përcaktuar trualli apo ndërtesash dhe pasurish të tjera të paluajtshme ku integrohen struktura kërkimore e zhvillimore dhe përfshihen entitete të cilat përdorin teknologji të avancuar në zhvillimin e produkteve ose shërbimeve, ose investojnë në kthimin e shpikjeve teknologjike në produkte finale, duke përfituar nga strukturat kërkimore të parkut dhe ka kuptimin e “zonës së lirë” sipas Kodit Doganor;

dh) “Përdorues” është personi fizik ose juridik, vendës ose i huaj, i cili ushtron veprimtari brenda parkut. Përdoruesi rezident i parkut regjistrohet në territorin e parkut me NIPT/NUIS parësor ose/dhe me NIPT/NUIS dytësor në territore të ndryshme nga territori i parkut. *Start-up*-et, punonjësit digjitalë lëvizës dhe institucionet e arsimit të lartë trajtohen në mënyrë të njëjtë për aq sa është e mundur si përdorues rezident apo të përfshirë në park sipas rregullave dhe kushteve të parashikuara posaçërisht për këto kategori me vendim të Këshillit të Ministrave;

e) “Produkt inovativ” është një produkt, i cili, po të krahasohet me gamën e mëparshme ekzistuese të produktit, paraqet ndryshime thelbësore teknologjike në material, pjesë apo funksion;

ë) “Zhvillues” është personi fizik ose juridik, vendës ose i huaj, i cili ndërton dhe administron funksionimin e parkut;

f) “Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve të një përdoruesi të parkut” është marrëveshja e lidhur ndërmjet një institucioni/enti/autoriteti publik/zhvilluesi kur është ent publik dhe përdoruesit të parkut, nëpërmjet së cilës përdoruesi i parkut me iniciativë apo me kërkesë nga enti/autoriteti/institucioni publik/zhvilluesi shet aksione apo krijon një shoqëri të përbashkët/sipërmarrje të përbashkët sipas kushteve dhe kriterëve të bazuara në një marrëveshje tip të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe të negociuara nga palët;

g) “Marrëveshja e bashkëpunimit për një produkt/shërbim inovativ” është akti i lidhur midis një institucioni/enti/autoriteti publik dhe një përdoruesi që ka aksionar një ent publik apo zhvilluesin, akt i cili bazohet në modelin tip të kontratës së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që përcakton ndër të tjera rregullat e bashkëpunimit, çmimin preferencial dhe kohën e përdorimit të produktit/krijimit/shërbimit/mallit të krijuar në park;

gj) “*Datacenter*” është infrastruktura fizike, teknologjike së bashku me sistemet mbështetëse në funksion të magazinimit, përpunimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së të dhënave elektronike në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt;

“h) “Park virtual/në distancë” është një formë organizimi i parkut teknologjik dhe shkencor, i cili krijohet në marrëveshje midis zhvilluesit dhe institucionit përgjegjës, pa kërkuar domosdoshmërisht një sipërfaqe të përcaktuar trualli. Ai funksionon përmes infrastrukturës digjitale dhe ofron lehtësitë rregullatore dhe fiskale të parashikuara në këtë ligj për përdoruesit që e ushtrojnë veprimtarinë në distancë, të cilët janë të regjistruar me NIPT primar në territorin e parkut dhe me NIPT sekondar të regjistruar jashtë tij.

#### Neni 4

#### **Miratimi i parqeve**

*(Shtuar fjali në pikën 3 me ligjin nr. 35/2026, datë 2.4.2026)*

1. Këshilli i Ministrave miraton hapjen e një parku në bazë të një propozimi që vjen nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

2. Propozimi për miratimin e parkut përfshin:

a) kufijtë e zonës;

b) llojet e veprimtarive të përfshira, sipas neneve 1 dhe 5 të këtij ligji.

3. Veprimtaria e parkut fillon pas përcaktimit të zonës, të portave të hyrjes e të daljes dhe të funksionimit të pikës doganore. Veprimtaria e parkut virtual/në distancë fillon me lidhjen e marrëveshjes midis zhvilluesit dhe institucionit përgjegjës.

#### Neni 5

#### **Veprimtaritë e lejuara**

*(Hequr fjalë në pikën 1, shtuar shkronja “d” në pikën 2, shtuar pika 4 me ligjin nr. 35/2026, datë 2.4.2026)*

1. Veprimtaritë e lejuara në park janë të kufizuara në veprimtari kërkim-zhvillimi, në funksion të qëllimeve të përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, dhe jo në prodhimin në seri të produkteve.

2. Veprimtaritë e lejuara në park përfshijnë veprimtari që:

a) angazhohen në kërkim-zhvillim, me qëllim përfitimin e njohurive të reja teknologjike apo shkencore, të cilat mundësojnë zhvillimin e produkteve apo të shërbimeve;

b) krijojnë metoda të reja të prodhimit të produkteve apo të shërbimeve ose përdorin teknologji të avancuar në prodhimin e *software*-eve, në përpunimin e të dhënave ose në veprimtari të ngjashme;

c) përmirësojnë produkte dhe shërbime në një mënyrë që sjell ndryshim thelbësor, jo të një natyre estetike, në pjesë apo në funksion, krahasuar me produktet ekzistuese;

ç) fokusohen në trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve, me qëllim angazhimin e tyre në prodhimin e produkteve dhe të shërbimeve inovative;

d) krijojnë dhe mirëmbajnë infrastruktura digjitale për shërbime/produkte digjitale apo *datacenter*-s.

3. Brenda kuadrit të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit, Këshilli i Ministrave mund të miratojë veprimtari të tjera të lejuara.

4. Veprimtaritë e lejuara në park mund të zhvillohen në mënyrë virtuale/në distancë, në mënyrë fizike apo hibride sipas marrëveshjes së zhvillimit të miratuar nga institucioni përgjegjës, si dhe të parashikuara në aktin e shpalljes së parkut.

## KREU II

## ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I PARQEVE

#### Neni 6

#### **Institucioni përgjegjës**

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë është institucioni përgjegjës, që ndjek të gjitha veprimtaritë e nevojshme për zbatimin e këtij ligji dhe, në veçanti për nxitjen, identifikimin, shpalljen dhe kontrollin e mirëfunksionimit të parqeve.

2. Sipas nevojës, Këshilli i Ministrave mund të krijojë Agjencinë e Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Parqeve Teknologjike dhe Shkencore (në vijim Agjencia) nën varësinë e ministrisë përgjegjëse për ekonominë në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar.

#### Neni 7

#### **Kompetencat e institucionit përgjegjës**

Institucioni përgjegjës ka këto detyra kryesore:

a) harton politikat për zhvillimin e parqeve;

- b) harton kriteret, rregullat dhe procedurat e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e parqeve;
- c) identifikon parqet potenciale dhe përgatit procedurat për shpalljen e tyre nga Këshilli i Ministrave;
- ç) përzgjedh zhvilluesin sipas kriterëve dhe procedurave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- d) ndihmon zhvilluesin dhe përdoruesit për krijimin, zhvillimin dhe funksionimin e parqeve.

#### Neni 8

##### **Zhvilluesi**

*(Shtuar fjali në fund të pikës 5 me ligjin nr. 35/2026, datë 2.4.2026)*

1. Çdo person fizik ose juridik mund të paraqesë kërkesën për të zhvilluar një park sipas kriterëve dhe rregullave të parashikuara në aktet nënligjore përkatëse.
2. Institucioni përgjegjës përzgjedh zhvilluesin në përputhje me aktet nënligjore përkatëse dhe palët nënshkruajnë marrëveshje ku parashikohen angazhimet reciproke.
3. Zhvilluesi mund të lidhë kontratë administrimi të parkut me persona të tjerë fizikë ose juridikë, të huaj ose vendës. Në çdo rast, zhvilluesi mbetet përgjegjës për detyrimet e tij ndaj institucionit përgjegjës dhe organeve shtetërore.
4. Zhvilluesi përzgjedh përdoruesit e parkut sipas procedurave të miratuara me akte nënligjore dhe hyn në marrëdhënie kontraktuale me ta.
5. Zhvilluesi i parkut duhet të sigurojë përfshirjen e një institucioni të arsimit të lartë, vendës ose të huaj, të akredituar sipas legjislacionit përkatës të vendit të origjinës. Institucioni i arsimit të lartë mund të ushtrojë veprimtaritë e lejuara në park, si dhe të ofrojë arsim të lartë ose kualifikim profesional pas arsimit të mesëm dhe, sipas llojit të institucionit, edhe kërkim shkencor në përputhje me veprimtaritë e lejuara në park, në cilësinë e përdoruesit rezident në bazë të një marrëveshje të veçantë të lidhur me zhvilluesin sipas kushteve, kriterëve dhe rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Mosmarrëveshjet ndërmjet institucioneve shtetërore dhe zhvilluesit apo përdoruesit mund të zgjidhen në mënyrë administrative, me ndërmjetësim, me arbitrazh ose në rrugë gjyqësore.
7. Në rast se miratohet hapja e një parku sipas pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, zhvilluesi përfiton të njëjtat lehtësira si në nenin 21 të ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të shpronësimit sipas nenit 28 të tij.

#### Neni 9

##### **Parqet në truall shtetëror ose privat**

1. Pasuritë e paluajtshme në të cilat krijohet parku merren në përdorim nga zhvilluesi pas lidhjes së kontratës së qirasë për një periudhë kohore jo më pak se 20 vjet, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Zhvilluesi gëzon të drejtën e dhënies së pasurisë së paluajtshme me nënqira të përdoruesit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. E drejta e përdorimit të pronës së paluajtshme shtetërore nëpërmjet kontratës së qirasë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Në rastin kur trualli ose pasuritë e tjera të paluajtshme janë pronë private, kandidati për zhvillues paraqet pranë institucionit përgjegjës kërkesën për shpalljen e parkut, pasi të jetë përcaktuar marrëdhënia me pronarin e truallit apo të pasurive të tjera të paluajtshme, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### KREU III

##### **LEHTËSITË RREGULLATORE DHE FISKALE**

#### Neni 10

##### **Lehtësitë rregullatore**

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2026, datë 2.4.2026)*

1. Institucionet, entet dhe autoritetet publike:

a) trajtojnë kërkesat për leje dhe licenca nga zhvilluesi ose përdoruesi brenda 15 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës, sipas lehtësirave të ngjashme rregullatore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë;

b) njihen në mënyrë prioritare me mallrat/shërbimet/krijimet e realizuara në park nga ana e përdoruesve nëpërmjet katalogut të përditësuar të publikuar/ofruar nga zhvilluesi periodikisht;

c) përfitojnë në mënyrë preferenciale mallrat/shërbimet/krijimet/produktet e realizuara në park nga një përdorues që ka aksionar mbi 51% një ent publik apo një shoqëri të përbashkët/sipërmarrje të përbashkët me një ent publik kundrejt një çmimi preferencial që parashikohet në marrëveshjen e bashkëpunimit për një produkt inovativ, bazuar në kontratën e modelit tip të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) lidhin marrëveshje bashkëpunimi për një produkt inovativ me përdoruesit, të cilët kanë aksionar një apo më shumë ente publike, përfshirë edhe zhvilluesin, lidhur me mallrat/shërbimet/produktet inovative/krijimet e tyre në park.

2. Për shkaqe të arsyeshme, që lidhen me kompleksitetin e licencave dhe të lejeve, afati mund të shtyhet vetëm një herë për një periudhë kohore prej 15 ditësh pune, sipas lehtësirave të ngjashme rregullatore të përcaktuara në ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Në rast se institucionet, entet dhe autoritetet publike nuk shprehen edhe pas këtij afati të dytë, atëherë aprovimi konsiderohet i dhënë.

4. Institucioni përgjegjës, me kërkesë të zhvilluesit ose të përdoruesit, mund të asistojë në aplikim pranë institucioneve, enteve apo autoriteteve publike që lëshojnë lejet ose licencat përkatëse.

#### Neni 11

##### **Infrastruktura ndihmëse**

Shteti ndërton infrastrukturën e përgjithshme deri në kufijtë e parkut, sipas mundësive, dhe kjo miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në vendimin, ku miratohet ndihma me infrastrukturë, përcaktohen dhe organet e ngarkuara për realizimin e saj.

#### Neni 12

##### **Lehtësitë fiskale**

*(Ndryshuar shkronja “d” e pikës 1, shtuar shkronja “e/1”, shtuar pika 5 me ligjin nr. 35/2026, datë 2.4.2026)*

1. Zhvilluesi dhe përdoruesit në park përfitojnë lehtësitë fiskale si më poshtë:

a) hyrja dhe dalja e mallrave në/nga park/u, të cilat shërbejnë për nxjerrjen e “produktit inovativ”, formalitetet dhe procedurat përkatëse kryhen sipas dispozitave të Kodit Doganor;

b) furnizimi i mallrave shqiptare të destinuar për t'u vendosur në park, të cilat shërbejnë për nxjerrjen e "produktit inovativ", konsiderohen si furnizim për eksport me shkallë 0 (zero), në përputhje me përcaktimet e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe të legjislacionit doganor;

c) norma e tatimfitimit është 0 (zero) për 15 vite të njëpasnjëshme për ato të ardhura që gjenerohen nga veprimtaritë, të cilat zhvillohen në park;

ç) pagat e personelit që punon në kërkim-zhvillim të përdoruesit në park dhe i gjithë stafi i zhvilluesit përjashtohen nga të gjitha taksat për një periudhë 10-vjeçare;

d) aplikohet shkalla 0 (zero) për qind e TVSH-së, për:

i. mallrat, pajisjet dhe shërbimet e përdorura në park, të cilat shërbejnë për nxjerrjen e produktit inovativ, si dhe tarifa e aplikuar nga zhvilluesi/menaxhuesi tek përdoruesi.

ii. produktet, shërbimet dhe zgjidhjet inovative të krijuara në park nga përdoruesit me aksionar entin publik mbi 51%, të cilat përdoren nga institucionet, entet dhe autoritetet publike për ushtrimin e funksioneve publike dhe që nuk hyjnë në qarkullim tregtar. Në këto raste, produkti inovativ trajtohet si mall apo shërbim i prodhuar për nevojat shtetërore dhe nuk konsiderohet furnizim i tatueshëm sipas legjislacionit në fuqi për TVSH-në.

iii. produktet, shërbimet dhe zgjidhjet inovative të krijuara në park, të cilat përdoren nga subjekte jashtë parkut për të cilat legjislacioni i fushës aplikon shkallën 0 të TVSH-së apo përjashtim të saj;

dh) përjashtohen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

e) përjashtohen nga taksa e pasurisë së paluajtshme për një periudhë 10-vjeçare për ndërtimet e realizuara në park;

e/1) ofrojnë/shesin/shkëmbejnë aksione me një ent publik në këmbim të një transaksioni financiar apo në natyrë sipas kushteve dhe termave të negociuar në marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve të një përdoruesi të parkut";

ë) kostot e trajnimit për punonjësit shkencorë dhe teknikë në park mund të rimbursohen pjesërisht nga shteti sipas kriterëve, rregullave dhe procedurave respektive të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Transferimi i një veprimtarie ekzistuese në territorin shqiptar në park, me qëllim kryesor përfitimin e lehtësive të parashikuara në këtë ligj, është i ndaluar. Çdo transaksion, që në thelb rezulton në transferimin e veprimtarisë ekonomike sipas përcaktimit të mësipërm, është i ndaluar.

3. Këshilli i Ministrave miraton kriteret, rregullat dhe procedurat për përfitimin nga lehtësitë fiskale.

4. Lehtësitë fiskale pasqyrohen në kontratat respektive të lidhura ndërmjet zhvilluesit dhe institucionit përgjegjës, si dhe zhvilluesit e përdoruesit dhe njoftohen organet përkatëse të tatimeve për secilin rast.

5. Shoqëritë e përbashkëta të krijuara ndërmjet një përdoruesi dhe një enti publik, si edhe përdoruesit të cilët kanë aksionar një ent/autoritet publik, pavarësisht kuotës së aksioneve, bashkëpunojnë me institucionet/entet/autoritetet publike në kushtet e marrëveshjes së bashkëpunimit për një produkt/shërbim inovativ bazuar në marrëveshjen tip të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në bazë të negocimit përkatës të autorizuar nga organet vendimmarrëse sipas legjislacionit të zbatueshëm.

## Neni 13

### Hyrja e dalja e mallrave dhe e shërbimeve

1. Në park hyjnë dhe dalin të gjitha mallrat dhe ofrohen të gjitha shërbimet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, pavarësisht nga natyra, cilësia, origjina, prejardhja ose vendmbërritja e tyre, me përjashtim të mallrave, importimi, eksportimi

dhe/ose tranzitimi i të cilave është i ndaluar në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi.

2. Furnizimi i shërbimeve të ofruara ndaj zhvilluesit dhe/ose përdoruesit të shërbimit brenda parkut përfiton të gjitha lehtësitë që zbatohen për eksportin e furnizimit të shërbimeve.

3. Rregullat dhe procedurat për hyrjen e daljen e mallrave e të shërbimeve në/nga park/u, si dhe për mallrat për përdorim vetjak, sipas ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” përdoren edhe në rastin e parkut.

#### Neni 14

##### **Pagesat**

Pagesat që lidhen me veprimtarinë e personave fizikë dhe juridikë, që veprojnë brenda parkut, mund të kryhen me monedhën e vendit ose me monedhë të huaj.

#### Neni 15

##### **Pronësia intelektuale**

*(Ndryshuar pikat 2 dhe 3, shtuar pikat 4 dhe 5 me ligjin nr. 35/2026, datë 2.4.2026)*

1. Përdoruesit në park duhet të regjistrojnë pronësinë intelektuale për krijimet e zhvilluara në park edhe me autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

2. Zhvilluesi ndihmon përdoruesit me regjistrimin e krijimeve në Republikën e Shqipërisë dhe në përdorimin e tyre nga institucionet/entitet publike sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit për një produkt inovativ të negociuara mes përdoruesit, zhvilluesit dhe institucionit/entitet publik përfitues.

3. Zhvilluesi mund të përfitojë një pjesë të të ardhurave që gjenerohen nga pronësia intelektuale, nga transaksionet e lidhura me ofrimin e shërbimit/produktit/mallit për institucionet/entitet publike, për krijimet/mallrat/shërbimet që zhvillohen në zonë nga përdoruesit për një periudhë 5-vjeçare, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e lidhur ndërmjet zhvilluesit/institucionit/entitet publik dhe përdoruesit.

4. Të dhënat e përdorura për qëllim të krijimit të produkteve inovative, nëse janë pronë e institucioneve publike, në bazë të marrëveshjes me zhvilluesit e parkut mund të përdoren nga përdoruesit që kanë aksionar një entitet/institucion/autoritet publik me kusht që produkti të përdoret ekskluzivisht prej një institucioni/enti/autoriteti publik apo një entitet tjetër të autorizuar/miratuar prej tij apo në zbatim të një marrëveshje ndërqeveritare. Në përdorimin e të dhënave përdoruesi zbaton parashikimet e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

5. Aksesit në bazat e të dhënave shtetërore jepet për zhvilluesin nëse është entitet publik sipas rregullave të legjislacionit sektorial.

#### KREU IV

##### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### Neni 16

##### **Fitimi i tatueshëm**

Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të pasqyrave financiare sipas ligjit për kontabilitetin, ligjit për tatimin mbi të ardhurat dhe përcaktimeve të bëra në këtë ligj. Subjektet e këtij ligji përdorin standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

#### Neni 17

## **Përdorimi i të ardhurave**

Të ardhurat që përfiton institucioni përgjegjës nga licencat dhe kontratat me subjektet e parqeve, përdoren në përputhje me aktet nënligjore që rregullojnë krijimin dhe administrimin e të ardhurave të krijuara nga institucionet shtetërore.

### **Neni 18**

#### **Aktet nënligjore**

*(Shtuar pika 4 me ligjin nr. 35/2026, datë 2.4.2026)*

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, shkronja “ç”; nenit 8, pika 4; nenit 9, pikat 1 e 2, dhe nenit 12, pika 3, të këtij ligji.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që rast pas rasti të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 5, pika 3; nenit 6, pika 2; nenit 7, shkronja “c”, dhe nenit 11 të këtij ligji.
3. Ngarkohet institucioni përgjegjës që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, shkronja “b”, të këtij ligji.
4. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 1, pikat 1 dhe 2; të nenit 4, pika 2; të nenit 5, shkronja “c”, dhe të nenit 6, pika 2, të këtij ligji.

### **Neni 19**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.7.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 13841, datë 3.8.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bajram Begaj.**